




**SI TA MBËSHTESË SHKOLLA
ZHVILLIMIN NË KARRIERË
TË ARSIMTARËVE?**



PSE ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE NË KARRIERË I KUADRIT EDUKATIVO-ARSIMOR ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR SHKOLLËN?

Që të thuhet për një shkollë se është e mirë duhet që ajo të arrijë vazhdimisht rezultate të mira dhe të avancojë punën e saj. Për të arritur këtë nevojitet që të gjithë të mësojnë dhe të avancohen. Kur thuhet "të gjithë mësojnë" nuk mendohet vetëm për nxënësit, por edhe të punësuarit. Prandaj, njëri prej kushteve të nevojshme që një shkollë të jetë efektive është kujdesi për kuadrin si dhe zhvillimin dhe avancimin e tij profesional.

Zhvillimi profesional nënkupton:

- nxënie
- përgatitje për ndryshime
- përgatitje për zgjidhjen e problemeve specifike profesionale
- ndryshime në sjellje dhe në punë
- ndryshime në procesin e mësimdhënies
- avancim të kuadrit
- ndjenjë se individi është i respektuar dhe i vlerësuar në vendin e tij të punës.

ZHVILLIMI PROFESIONAL nuk ka të bëjë vetëm me akumulimin e njohurive të reja, por edhe zbatimin e tyre në praktikë dhe gatishmëri për përfshirjen e ndryshimeve në mënyrën e punës, në raport me nxënësit, kolegët dhe prindërit, si dhe në mënyrën e komunikimit që praktikohet në shkollë. Ai njëherësh shpie drejt avancimit në karrierë të kuadrit edukativo-arsimor.

Është krenari për secilën shkollë që në radhët e saj të ketë arsimtarë që kanë treguar profesionalizëm dhe përkushtim të lartë në punën e tyre dhe kanë merituar të avancohen në profesionin e tyre.

Ata duhet të jenë të vërejtur dhe të mbështetur nga shkolla, për shkak se me avancimin e tyre shkolla fiton profesionistë që do të jenë mbështetje e fuqishme në zhvillimin profesional të kolegëve të tyre dhe do të kontribuojnë për përparimin e gjithë shkollës. Këta arsimtarë, jo vetëm që i posedojnë kompetencat themelore profesionale, por përmbushin edhe një pjesë më të madhe të standardeve për avancim në titull mentor ose këshilltar. Me këtë, ata në fakt edhe janë të dalluar në shkollë si njerëz që veçohen për shumë gjëra, veçanërisht në aspektin e mënyrës së punës dhe komunikimit, përkushtimit, praktikimit të bashkëpunimit dhe posedimit të vlerave të larta etike.

Shkollat e mira janë të interesuara, të motivuara dhe të angazhuara për t'i mbështetur arsimtarët e tyre në zhvillimin e tyre profesional dhe në karrierë.

SI ËSHTË E PËRFSHIRË SHKOLLA NË PROCESIN E ZHVILLIMIT NË KARRIERË TË ARSIMTARËVE?

Në procesin e zhvillimit në karrierë të arsimtarëve vlerësimi i përmbushjes së standardeve për avancim në titull bëhet prej disa aspekteve, me ç'rast për arritjen e disa standardeve të caktuara më adekuate është që vlerësimin ta bëjë shkolla.

Për këtë qëllim kuadri edukativo-arsimor në shkollë duhet të jetë i njoftuar me:

- **Kompetencat themelore profesionale që duhet t'i posedojë arsimtari;**
- **Standardet profesionale për arsimtar-mentor**
- **Standardet profesionale për arsimtar-këshilltar**

Vlerësimi i shkollës bëhet për atë arsimtar që përgatitet dhe është paraqitur për avancim në titull. Me qëllim që të sigurohet transparencë në gjithë procesin dhe që të fitohen informacione që do të jenë mjaft të besueshme, shkolla duhet t'i përfshijë të gjithë faktorët e procesit edukativo-arsimor. Shkolla e mbështetë vlerësimin e saj në informacione që i merr prej katër burimeve:

- prej prindërve
- prej nxënësve
- prej arsimtarëve
- dokumentacionit të shkollës.

SI ZBATOHET PROCESI I MBLEDHJES SË INFORMACIONEVE?

Informacionet që janë marrë prej nxënësve, prindërve dhe arsimtarëve mblidhen përmes anketës, me ç'rast:

- Anketën me nxënësit dhe me arsimtarët e zbaton ekipi për zhvillim profesional.
- Anketën me prindërit e zbaton ekipi i Këshillit të Prindërve.

Për arsimtarët e mësimit klasor në shkollë fillore anketa me nxënës dhe prindër zbatohet në paralelen që e udhëheqë arsimtari.

Te nxënësit e klasës së parë dhe të dytë zbatohet në formë të bisedës me të gjithë nxënësit në raport me pyetjet e përfshira në anketën dhe mbahen shënime.

Për arsimtarët të cilët ligjërojnë mësim lëndor në shkollë fillore dhe në shkollë të mesme anketa me nxënës dhe prindër zbatohet në paralelet në të cilat arsimtari ligjëron në vitin rrjedhës, me atë që nga secila paralele anketën e marrin 20% e numrit të përgjithshëm të nxënësve, të cilëve arsimtari u ligjëron dhe përqindje të njëjtë të prindërve, sipas përzgjedhjes së rastësishme.


Për fushën **KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË** si burim i informacioneve do të shfrytëzohet edhe dokumentacioni shkollor – raport vjetor për punën e shkollës, informator për ngjarje të rëndësishme, si dhe evidencë të arsimtarit për bashkëpunim të realizuar.

Listat e plotësuara të anketave duhet të ruhen dhe të jenë të arritshme për shqyrtimin e tyre.

SI TË BËHET VLERËSIMI I PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE?

Gjatë vlerësimit të përbushjes së standardeve është e domosdoshme që të vepohet në mënyrë objektive dhe të paanshme. Në interes të shkollës është që të avancohet ai arsimtar që me të vërtetë i ka arritur standardet për titull të caktuar, meqë kjo nuk është vetëm mirënjohje për arsimtarin, por edhe obligim i tij që më tutje me përkushtim, përgjegjësi dhe iniciativë edhe më të madhe të angazhohet në zhvillimin e shkollës. Njëherësh, arsimtarët, nxënësit dhe prindërit duhet të jenë të bindur se me të vërtetë avancohet më i miri, me çka sigurohet mbështetje e gjithë procesit të avancimit në karrierë.

Për këtë qëllim, pasi që ekipet do t'i përpunojnë të dhënat nga secila anketë veç e veç, në të njëjtat duhet të bëhen kryqëzime dhe së bashku, në bazë të të dhënave të përpunuara në këtë mënyrë, të vlerësojnë përbushjen e standardeve.




BURIME TË INFORMACIONEVE PËR PËRMBUSHJEN E STANDARDEVE QË I VLERËSON SHKOLLA

	ANKETË ME			BURIME TJERA
	NXËNËS	PRINDËR	ARSIMTARË	
MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE				
E bën mësimin interesant dhe nxitë interes te nxënësit për nxënie të lëndës mësimore.	✓	✓		
Informon prindërit për përparimin e fëmijës së tyre, rregullisht dhe në mënyrë cilësore.		✓		
I merr në pyetje dhe respekton qëndrimet, mendimet dhe interesat e nxënësve.	✓	✓		
KRIJIM I MJEDISIT STIMULUES PËR NXËNIE				
E respekton personalitetin e nxënësit, e nxitë dhe zhvillon vetëbesimin dhe vetërespektin e tij.	✓	✓		
Shfrytëzon stil përkatës të komunikimit me nxënësit.	✓	✓		
Kontribuon në krijimin e klimës pozitive shkollore dhe komunikim.	✓	✓	✓	
INKLUZION (PËRFSHIRJE) SOCIAL DHE ARSIMOR				
Përgatitë nxënësit që t'i pranojnë fëmijët e grupeve të ndjeshme dhe fëmijët me nevoja të posaçme arsimore.	✓	✓		
KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME FAMILJEN DHE BASHKËSINË				
Komunikon me familjet në mënyrë përkatëse me respekt dhe kujdes.		✓		

	ANKETË ME			BURIME TJERA
	NXËNËS	PRINDËR	ARSIMTARË	
Zhvillon bashkëpunim efektiv me familjet dhe anëtarët e bashkësisë në punën e shkollës. <i>Për arsimtarët e lëndëve profesionale dhe mësimin praktik:</i> Komunikon me mjedisin lokal, partnerët social dhe institucione tjera relevante në shtet dhe jashtë tij.		✓		✓ Raport vjetor ✓ Evidencë e arsimit për bashkëpunimin e realizuar
Përmirëson bashkëpunimin e shkollës me familjen dhe bashkësinë lokale. <i>Për arsimtarët e lëndëve profesionale dhe mësimin praktik:</i> Bashkëpunim me punëdhënës për realizimin e trajnimit praktik.				✓ Raport vjetor ✓ Evidencë e arsimit për bashkëpunimin e realizuar
ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL				
Respekton etikën profesionale dhe sillet në mënyrë të përgjegjshme ndaj detyrimeve dhe me kolegët.		✓	✓	
Promovon marrëdhënie kolegjinale dhe bashkëpunon me kolegët.			✓	
Promovon dhe praktikon modele të sjelljes etike në të gjitha llojet e komunikimit profesional (me nxënës, kolegë dhe bashkësinë më të gjerë).	✓	✓	✓	

Gjatë zbatimit të anketës duhet pasur kujdes që pyetjet të japin informacione të mjaftueshme që kanë të bëjnë me kompetencat që arsimtari duhet t'i posedojë.



PRINDËRIT DUHET TË PYETEN:

- ▶ A e dinë se çfarë bën arsimtari për ta bërë mësimin interesant për nxënësit?
- ▶ Si sillet arsimtari me fëmijën e tyre, a komunikon me respekt, a tregon mirëkuptim për nevojat e tij, a sillet në mënyrë të drejtë ndaj tij, a e dëgjon dhe respekton mendimin e nxënësve?
- ▶ Sa shpesh marrin informacione nga arsimtari për përparimin e fëmijës së tyre?
- ▶ Cila është cilësia e informacionit që ua jep arsimtari (a përmban informacion për atë që është arritur, për atë që duhet të përmirësohet dhe drejtimit se si prindi mund të ndihmojë)?
- ▶ Çfarë bën arsimtari për të qenë të pranuar fëmijët e grupeve të ndjeshme në paralelen?
- ▶ Si komunikon arsimtari me ta, a mbështetet komunikimi në respekt dhe kujdes?
- ▶ A janë të përfshirë në aktivitete që arsimtari i realizon dhe në çfarë mënyre?

NXËNËSIT DUHET TË PYETEN:

- ▶ Çfarë bën arsimtari për ta bërë mësimin interesant për ta dhe nëse me të vërtetë u është interesant?
- ▶ A i pyet arsimtari për mendimin, propozimet e tyre dhe nëse i përfshin në aktivitete?
- ▶ Çfarë është ajo që u pëlqen te arsimtari i tyre, ndërsa nuk ka të bëjë me pamjen e tij?
- ▶ Si bisedon arsimtari me ta, si u drejtohet, a i dëgjon?

- ▶ A është arsimtari i drejtë ndaj të gjithë nxënësve (në raport me vëmendjen e kushtuar, përfshirjen në aktivitete, ndihmën e dhënë, notimin)?

ARSIMTARËT DUHET TË PYETEN:

- ▶ Çfarë është karakteristike, e dallueshme në sjelljen e kolegut të tyre, e që ndikon në klimën e përgjithshme në shkollë?
- ▶ Si sillet ndaj obligimeve?
- ▶ Si është komunikimi i tij me nxënësit, si është me prindërit, e si është me kolegët?
- ▶ Çfarë është ajo që si vlerë etike e dallojnë te kolegu i tyre?
- ▶ Në çfarë mënyre bashkëpunon me kolegët tjerë?
- ▶ Si e promovon shkollën? Si kontribuon për imazhin e shkollës?

Mënyra e shënimit dhe dorëzimit të vlerësimit të shkollës do të jetë e përcaktuar nga institucionet kompetente.



DOKUMENTE RELEVANTE

Ligji për arsimtarë

www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/zakon-za-osnovni-sredni-ucilishta.pdf

Kompetenca themelore profesionale për arsimtarë

www.bro.gov.mk/docs/pravilnici/Pravilnik%20za%20osnovnite%20profesionalni%20kompetencii%20na%20nastavnicite.pdf

Kompetenca themelore profesionale dhe standarde për arsimtar-mentor dhe për arsimtar-këshilltar

<http://bro.gov.mk/?q=mk/node/157>



Projekt për Zhvillim Profesional
dhe në Karrierë të Arsimitarëve



Byroja e Zhvillimit të Arsimit



QENDRA
MAqedonase për
EDUKIM
QYTETAR